



**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**GJYKATA E RRETHIT GJYQESOR**  
**TIRANE**

---

**Nr. 501 Akti**

**V E N D I M**

**“MBI KTHIMIN E SENDIT TE SEKUESTRUAR”**

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane e perbere nga:

**SOKOL TONA - G J Y Q T A R**

Asistuar nga sekretare gjyqesore **Dasantila BEJKO**, me pjesmarrjen e prokurores Znj.Alma Muça, sot me date **08 Qershor 2010**, perfundoi se shqyrtuari ne séance gjyqesore kerkesen penale me nr.501 akti qe i perket:

**KERKUES:** **E.SH** i biri i (.....) dhe i (.....) i dtl.(.....) lindur ne Tirane dhe banues ne (.....), aktualisht student, i padenuar, beqar, me kombesi e shtetesi shqiptare, mbrojtur ne kete gjykim nga avokat Nasi Keri me nr.1054 liç e Nipt K 72106012 I.

**OBJEKTI:** Heqje sekuestro per automjetin tip AUDI A-3 me targa (.....)me numer shasie (.....)

**Baza Ligjore:** Neni 212 i Kodit Proçedures Penale.

Gjykata si celi seancen gjyqesore, si degjoi avokatin dhe kerkuesin te cilet kerkuan pranimin e kerkeses, si degjoi prokuroren e cila kerkoi rrezimin e kerkeses, si administroi dhe shqyrtoi provat ne teresi:

**V E R E N**

Në këtë gjykatë ka paraqitur një kërkesë, kërkesi E.SH, i cili kërkon kthimin e sendit të sekuestruar nga Organi i Prokurorisë pranë Gjykatës së rrethit Gjyqesor Tirane, dhe konkretisht, nje automjet tip Audi (A3) me nr. shasie (.....) dhe me targe (.....), si edhe dokumentat shoqerues te ketij mjeti, pasqyruar ne proces verbalin e sekuestrimit te proves materiale date 22.11.2008.

Nga shqyrtimi gjyqësor i kësaj kërkesë rezulton se ajo është e drejtë, e mbështetur në provat që u administruan dhe si e tillë ajo duhet të pranohet.

Kështu u provua se Drejtoria e Policise se Qarkut Tirane, me proces verbalin date 22.11.2008, ka vendosur sekuestrimin e automjetit me te dhenat si me siper, se bashku me dokumentet shoqeruese te tij. Ky automjet ne kohen e sekuestrimit ka qene ne pronesi te shtetasit E.SH(kerkuesit) pronesi kjo e fituar me kontraten e shitblerjes nr.8931 rep. dhe 1428 kol. date 28.11.2007, te Dhomes se Noterise Tirane.

Rezultoni nga permbajtja e proces verbalit te sekuestrimit, se arsyeja e ketij sekuestrimi, eshte pasi ky automjet mund te jete I vjedhur.

Pikerisht, rreth arsyetimit si me siper, edhe prokurori ne seance gjyqesore, i kerkoj kesaj gjykate, rrezimin e kerkeses se kerkuesit E.SH.

Ne konkluzionin se kerkesa objekt gjykimi, duhet te pranohet, gjykata arrin duke konsideruar sa vijon:

Keshtu, gjate shqyrtimit gjyqesor, gjykata u be me dije, se ndonese nga ana e Oficerit te Policise Gjyqesore, prane Drejtorise se Policise se Qarkut Tirane, eshte mbajtur proces verbali i sekuestrimit si me siper, ai proces verbal, rezultoi i pa vleresuar nga prokurori si i ligjeshem, kriter ky i domosdoshem i parashikuar nga Ligjvenesit ne Nenin 301/2 i Kodit te Procedures Penale, ne te cilin ne menyre te shprehur percaktohet se "...Prokurori, brenda 48 oreve te ardheshme, me vendim te motivuar vlereson sekuestron, neqoftese ekzistojne kushtet, ose vendos kthimin e sendeve te sekuestruara...". Pikerisht, nga aktet e administruara, nuk ekziston asnje vendim mbi vleresimin e sekuestrimit si me siper, duke e bere ne kete menyre, veprimin procedural te sekuestrimit te mjetit dhe dokumentacionit te tij, te pavlefshem.

Po keshtu, nga ana e tij, kerkuesi E.SH, nepermjet avokatit, duke u legjitimuar ne kerkimet e tij, ai i paraqiti kesaj gjykate kontraten e shitblerjes se automjetit objekt gjykimi, nr.8931 rep. dhe 1428 kol. date 28.11.2007 te Dhomes se Noterise Tirane te cilen gjykata jo vetem e gjen ate ne perputhje me ligjin, por konstatohet se ne permbajtjen e saj midis te tjerave percaktohet se Shitesi ka garantuar bleresin me te gjitha dokumentacionin e e nevojshem ligjor, duke percaktuar ne kete menyre edhe poziten e mirebesimit te bleresit E.SH (kerkuesit). Pervec kontrates se shitblerjes si me siper, ne dosjen e parqitur nga organi i akuzes gjykata administroi edhe lejen e qarkullimit leshuar nga autoritetet perkatese Shqiptare, pikerisht me te dhenat e automjetit objekt gjykimi.

Edhe per sa i perket permbushjes se detyrimeve qe burojne nga legjislacioni doganor dhe ai fiskal, rezultoi se per automjetin me te dhenat si me siper, keto detyrime rezultojne te permbushura rregullisht.

Rreth faktit te mesiperme gjykata sjell bindjen duke iu referuar korespondences zyrtare midis Drejtorise se Pergjitheshme te Policise se Shtetit dhe asaj te Doganave ku sipas shkresave me nr.6990/1 prot date 14.09.2009, si edhe asaj me nr.1375 prot date 23.07.2009, konfirmohet se deklaratat doganore dhe vertetimet e zhdoganimit te automjetit objekt sekuestrimi, jane te rregullta dhe ato jane leshuar nga Dega e Doganes Durres.

Pikerisht, duke u mbeshtetur ne sa siper, si edhe ne faktin, se sic konstatohet kerkuesi E.SH, ndodhet ne pozitat e mirebesimit, gjykata vlereson se kerkesa eshte e drejte dhe si e tille ajo duhet te pranohet.

Siç u percaktua ne pjesen hyrese te ketij vendimi, ndonese kerkuesi E.SHkerkon kthimin e automjetit te sekuestruar me te dhenat si me siper, gjykata cmon se automjeti sekuestruar, se bashku me dokumentacionin e tij duhet ti kthehet kerkuesit E.SH, por duke ju lene atij ne ruajtje.

### **PER KETO ARSYE**

Gjykata bazuar ne Nenin 301/2 dhe 384 te Kodit Procedures Penale:

### **VENDOSI**

-Pranimin e kerkeses se kerkuesit **E.SH.**

-Heqjen e sekuestros per automjetin tip AUDI A-3 me targa (.....), me numer shasie (.....), dhe kthimin e atij mjete duke ia lene ate ne ruajtje kerkuesit E.SH, si dhe duke hequr sekuestron dhe duke ia kthyer ne ruajtje kerkuesit E.SH, dokumentet e automjetit te sekuestruara si me poshte:

1-Leje qarkullimi ne gjuhen shqipe per mjetin e mesiperm me nr.(.....) ne emer te shtetasit E.SH.

2-Takse vjetore e qarkullimit rrugor per mjetin e mesiperm dt.11.12.2007 me nr.189120.

3-Takse e rregjistrimit te pervitshem te mjetit te mesiperm dt.11.12.2007 me nr.189120.

4-Çertifikate e kontrollit teknik te mjetit te mesiperm dt.11.12.2007 me nr.0500719.

5-Police per sigurimin e detyrueshem te mbajtesve te mjeteve motorrike dt.30.11.2007 me nr.0358333.

-Shpenzimet gjyqesore siç jane bere.

-Kunder vendimit lejohet ankim sipas ligjit ne Gjykatën e Apelit Tirane.

**U shpall sot ne Tirane me dt. 08 Qershor 2010.**

**SEKRETARE**

**GJYQTAR**

**Dasantila BEJKO**

**SOKOL TONA**